

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**

KUKËS /  
RRETHI GJYQËSORI /  
SHQIPËRISË /



Nr. Rregj. Them. (75013-00194-55-2020) 220  
Data e rregj. 4/3/2020

Nr. Vendimi (396) 220  
Data e vendimit: 10/3/2020

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e përbërë nga gjyqtar Florin Demollari, asistuar nga sekretare gjyqësore Lazime Seferi, sot më datë 10/3/2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, çështjen penale me:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, përfaqësuar nga prokurore Rita Gjati.

**OBJEKT:** 1. Sekuestrimin e pasurive:

- a) Njësi me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239;
- b) Truall me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup>, plus ndërtesë me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61;
- c) Automjet “Mercedes – Benz”, tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj;
- d) Automjet “BMW”, tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj;
- e) Automjet “BMW”, tip X5, me targë AA818LD, në emër të Fation Nezir Dautaj;
- f) Automjet “Audi”, tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj;
- g) Bar – Kafe “Piano – Bar”, në rrugën “Petro Nini Luarasi”, në afërsi të “Shkollës së Baletit”, Tiranë, në emër të Servete Dautaj, me NIPT: L62402043D.

2. Caktimin e administratorit nga lista e ekspertëve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.



**BAZA LIGJORE:** Neni 4, 7, 11 të Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës (në vijim Gjykata) pas shqyrtimit në tërësi të kërkesës së bashku me aktet dhe provat në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve,

### VËREN:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (në vijim Prokuroria e Krimeve të Rënda), pas marrjes dijeni nga policia gjyqësore, ka filluar procedimin pasuror Nr. 113/2017, ndaj pasurive në zotërim të personit Fation Dautaj. Procedimi pasuror ka filluar për shkak të ngjarjes së ndodhur në lokalin “Piano Bar”, në rrugën “Petro Nini Luarasi” në Tiranë, në vitin 2013; ku pas tentativës për shkatërrimin e kësaj prone me eksploziv, ngeli i plagosur personi Fation Dautaj.

Në datë 25/9/2015 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës (në vijim Prokuroria e Kukësit), bazuar mbi dyshime të arsyeshme se ngjarja mund të ketë ndodhur për shkak të veprimtarisë kriminale të mëparshme të kryer prej personit Fation Dautaj në Angli; ka filluar procedimin penal ndaj tij, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga Nenin 287 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (në vijim KP).

Në datë 16/12/2019 Prokuroria e Krimeve të Rënda vendosi shpalljen e moskompetencës dhe dërgimin e akteve të procedimit pasuror Nr. 113/2017 Prokurorisë së Kukësit, e cila në datë 6/1/2020, bazuar në Ligjin Nr. 10192, datë 3/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim Ligji Antimafia), regjistroi procedimin pasuror Nr. 5, ndaj personit Fation Dautaj, të cilit i atribuohet vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga Neni 287 i KP. Në kuadër të këtij procedimi, në datë 4/3/2020, prokurori ka paraqitur kërkesë për sekuestrimin e pasurive dhe veprimtarisë tregtare si më poshtë vijon:

- Njësi me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239;
- Truall me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup>, plus ndërtësë me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61;
- Automjet “Mercedes – Benz”, tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj;
- Automjet “BMW”, tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj;



- e) Automjet “BMW”, tip X5, me targë AA818LD, në emër të Fation Nezir Dautaj;
- f) Automjet “Audi”, tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj;
- g) Bar – Kafe “Piano – Bar”, në rrugën “Petro Nini Luarasi”, në afersi të “Shkollës së Baletit”, Tiranë, në emër të Servete Dautaj, me NIPT: L62402043D.

Gjykata thekson se qëllimi i Ligjit Antimafia është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe kimeve të tjera përmes marrjes së masave parandaluese ndaj pasurive të personave, të cilët kanë një nivel të pajustifikuar ekonomik, si rezultat i veprimitarës së dyshuar kriminale.

Ligji Antimafia zbatohet ndaj pasurive, të cilat dyshohen se jane produkte të veprave penale. Në përbajtje të tij, Ligji përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave që janë subjekte të tij.

Ligji Antimafia disiplinon një proces gjyqësor të posaçëm, i cili është i pavarur nga procesi gjyqësor penal që mund të zhvillohet ndaj personave, të cilët njëkohësisht janë edhe subjekte të Ligjit Antimafia; pavarësisht lidhjes midis tyre për shkak të pasurisë të krijuar nga veprimitaria kriminale. Kuptimi i marrëdhënieve midis procedimit pasuror të posaçëm dhe procedimit penal parashikohet në Nenin 5 të Ligjit Antimafia, ku thuhet se:

*“1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.*

*2. Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.*

*3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtron, gjithashtu, sekuestrimi apo konfiskimi, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimi dhe konfiskimi, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.”*

Fusha e zbatimi të Ligjit Antimafia, parashikohet në Nenin 3 të tij, ku thuhet se:

*“1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:*



- a) pjesëmarrje dhe kryerje të kimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;
- b) pjesëmarrje dhe kryerje e kimeve nga organizata terroriste dhe kimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;
- c) kryerjen e kimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;
- ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;
- d) kryerjen e kimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/l, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

- a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezër, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përvçese kur provohet e kundërt;
- b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.



5. *Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimitarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.*

6. *Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtaritë kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.”*

Masat parandaluese, sipas Nenit 4 të Ligjit Antimafia, janë masa me karakter pasuror, të cilat vendosen nga gjykata në një procedim pasuror, nëpërmjet sekuestritimit të pasurive, veprimtarive ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave, subjekte të këtij ligji, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre.

Gjykata thekson se sekuestrimi i pasurive të dyshuara si produkte të veprimtarisë kriminale, kryhet vetëm nëse plotësohen kriteret e parashikuara në Nenin 11 të Ligjit Antimafia. Në këtë dispozitë, parashikohet se:

“1. Me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, gjykata vendos sekuestrimin e pasurive, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësi të plotë ose të pjesshme të personave, sipas nenit 3, pika 1, të këtij ligji, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi është përfshirë në veprimtaritë kriminale dhe zotëron pasuri apo të ardhura shpërpjesëtimore në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruara dhe që nuk përligjen prej tyre, si dhe kur:

a) ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji; ose

b) ka dyshime të arsyeshme që tregonjë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive të caktuara ekonomike, tregtare dhe profesionale janë në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale ose që mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale.

2. Kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë përmban indiciet, në të cilat bazohet dyshimi i arsyeshëm, si dhe arsyetimin për të paktën një prej kushteve të pikës I të këtij neni.

Në këtë kontekst faktik dhe ligjor, prokurori kërkon sekuestrimin e pasurive dhe veprimtarisë tregtare të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga personi Fation Dautaj, për shkak të dyshimeve të arsyeshme se ai është përfshirë në veprimtari kriminale të kryera në Angli dhe niveli i të ardhurave apo



fitimeve nga veprimitari të ligjshme të deklaruara prej tij apo personat e afërm të tij nuk përligj pasurinë e zotëruar prej tyre.

Gjkata përparrë së gjithash, vlerëson se në kuadër të procedimit pasuror prokurori ka kryer hetimet e nevojshme ndaj personit Fation Dautaj dhe personave të afërm të tij për mjetet financiare, pasuritë, veprimitaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik dhe burimet e të ardhurave të tyre.

Nga shqyrtimi i të dhënave të mbledhura deri në këtë fazë të procesit nga prokurori, Gjkata çmon se ekzistojnë dyshime të arsyeshme që tregojnë se personi Fation Dautaj mund të ketë kryer veprat penale “Trafikimi i lëndëve narkotike” dhe “Pastrimi i produktive të veprës penale” në Angli. Nga shqyrtimi i informacionit të dhënë me Shkresën Nr. 3107/1 Prot., datë 11/4/2019 nga Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve, Licensimit dhe Certifikimit dhe kqyrja e sistemit TIMS në datë 28/2/2020, rezulton se në pronësi të personit Fation Dautaj dhe personave të afërm të tij, konkretisht: babait Nezir Dautaj dhe vëllait Isuf Dautaj janë regjistruar në regjistrat publik automjetet: “BMW”, tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Dautaj; “BMW”, tip X5, me targë AA818LD, në emër të Fation Dautaj; “Mercedes – Benz”, tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj dhe “Audi”, tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Dautaj. Nga shqyrtimi i informacionit të dhënë me Shkresën Nr. 1372/1 Prot., datë 16/12/2019 nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Vendore Tiranë (në vijim ASHK Tiranë) rezulton se në pronësi të personit Nezir Dautaj, babait të personit Fation Dautaj janë regjistruar në regjistrat publik pasuritë e paluajtshme: njësi me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239 dhe truall me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup>, plus ndërtësë me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61. Nga shqyrtimi i informacionit të dhënë me Shkresën Nr. 2891/1 Prot., datë 20/2/2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim DPT), rezulton se:

- a) në emër të personit Fation Dautaj nuk ka të regjistruar veprimitari tregtare;
- b) në emër të personit Nezir Dautaj, babait të personit Fation Dautaj është regjistruar veprimitaria tregtare me NIPT: L67407971K, me objekt rritjen e kafshëve, me status “aktiv”;
- c) në emër të personit Servete Dautaj, nënës së personit Fation Dautaj është regjistruar veprimitaria tregtare me NIPT: L62402043D, me objekt shërbimin e pijeve, me status “aktiv”;
- d) në emër të personit Isuf Dautaj, vëllait të personit Fation Dautaj është regjistruar veprimitaria tregtare me NIPT: L42229009M, me objekt kafene dhe bar-bufe, me status “kërkësë për çregjistrim, datë 25/11/2016”.

Nga shqyrtimi i informacionit të dhënë me Shkresën Nr. 1002/1 Prot., datë 12/2/2019 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSH), rezulton se personi Fation Dautaj nuk



rezulton të ketë paguar sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Gjithashtu rezulton se babai tij Nezir Dautaj ka përfituar pension nëntoke fillimisht me masë përfundimtare 6,013 Lekë nga muaji dhjetor 2000 dhe në vitet në vijim në masën e indeksuar. Nëna e tij, Servete Dautaj, rezulton se nga muaji maj 2014 deri në shtator 2014 të jetë paguar me pagë bruto 22,000 Lekë në muaj nga një subjekt tregtar, i cili i ka paguar edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhe, ndërsa nga muaji dhjetor 2016 deri në muajin dhjetor 2018, Servete Dautaj rezulton të jetë e vetëpunësuar, me page bruto minimale 22,000 Lekë (5 muaj), 24,000 Lekë (6 muaj) dhe 28,000 Lekë (11 muaj). Së fundmi, nga të dhënrat e marra nga ISSH rezulton se personi Isuf Dautaj, vëllai i personit Fation Dautaj ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar me pagë bruto minimale 22,000 Lekë në muaj nga muaji dhjetor 2014 deri në muajin nëntor 2016.

Në këtë kontekst, nga shqyrtimi në tërësi i të gjitha të dhënave të mbledhura nga prokurori, Gjykata çmon se, pasuritë e luajtshme të llojit automjete, të markës “BMW” X5, me targë AA999IS dhe AA818LD, të regjistruara në emër të personit Fation Dautaj, dyshohet se janë produkte të veprimtarisë kriminale të kryer prej tij në Angli, duke qenë se Fation Dautaj nuk ka dekluaruar veprimitari të ligjshme, prej të cilave mund të ketë përfituar të ardhura të ligjshme. Gjykata gjithashtu, çmon se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se edhe pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme dhe veprimtaria tregtare, të regjistruara në emër të personave të afërm të personit Fation Dautaj, konkretisht: në emër të babait të tij Nezir Dautaj, nënës Servete Dautaj dhe vëllait Isuf Dautaj, janë produkte të veprimtarisë kriminale të kryer nga personi Fation Dautaj në Angli, për shkak se burimet e ligjshme të të ardhurave të përfituar nga veprimitari të ligjshme të deklaruara prej tyre, nuk justifikojnë ligjërisht vlerën e pasurive të regjistruara në emrin e tyre. Personat e afërm të personit Fation Dautaj nuk arrijnë të përligjin zotërimin e këtyre pasurive, të cilat janë shpërpjesëtimore me nivelin e të ardhurave apo fitimeve të realizuara nga burime të ligjshme të deklaruara prej tyre. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se regjistrimi i këtyre pasurive në emër të personave të afërin të personit Fation Dautaj prezumohet i rremë. Për më tepër, në çështjen në shqyrtim nuk u paraqit asnjë e dhënë, nga e cila të provohet ose të paktën të dyshohet se personi Fation Dautaj dhe personat e afërm të tij mund të kenë përfituar të ardhura të ligjshme nga veprimitari, të cilat edhe pse mund të mos janë dekluarar në përputhje të plotë me ligjin vërtetohet që nuk janë kriminale.

Kështu, Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim, kriteret për sekuestrimin e pasurisë, të parashikuara në Nenin 11 të Ligjit Antimafia përbushen plotësisht, sepse ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicje se personi Fation Dautaj ka kryer veprat penale “Trafikimi i lëndëve narkotike” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” në Angli dhe pikërisht nga kjo veprimitari dyshohet se është përfituar pasuria e përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Por është e rëndësishme të theksohet se, sipas Nenit 12, paragrafi 2 i Ligjit Antimafia, masa e sekuestritimit është e përkohshme, e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj.



Gjykata vëren se, prokurori kërkon edhe caktimin e administratorit për administrimin e pasurive që kërkon të sekuestrohen. Gjykata çmon se, administratori apo administratorët, caktohen sipas procedurës të parashikuar në Nenin 15 të Ligjit Antimafia, ku ndër të tjera parashikohet se:

*“1. Gjykata, në vendimin e sekuestrimit të pasurisë, cakton, gjithashtu, nga lista e ekspertëve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara një a më shumë administratorë. Agjencia vë në dispozicion të gjykatës lisën e administratorëve, me persona të punësuar ose të autorizuar prej saj, të paktën një herë në vit dhe tregon kriteret e caktimit të tyre...”*

Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata çmon të ngarkojë Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (në vijim AAPS) të caktojë një ose më shumë administratorë, për shkak se nga kjo e fundit nuk është vënë në dispozicion të Gjykatës, lista e administratorëve, me personat e punësuar apo të autorizuar prej saj. Gjithashtu AAPS është e detyruar të njoftojë Gjykatën për administratorin e caktuar prej saj, i cili është i detyruar të raportojë në Gjykatë për veprimtarinë e kryer prej tij, në përputhje me Nenin 18 të Ligjit Antimafia, ku thuhet se:

*“1. Brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, administratori detyrohet t'i paraqesë gjykatës një raport të hollësishëm për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes, në të cilën ndodhet pasuria e sekuestruar. Në vijim, sipas afateve të caktuara nga gjykata, administratori i paraqet asaj raporte periodike për administrimin e pasurisë së sekuestruar, të shoqëruara, nëse kërkohet, me dokumentacionin përkatës.*

*2. Administratori është i detyruar të njoftojë gjykatën edhe për pasuri të tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit.*

*3. Administratori detyrohet që raportet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij nenit t'ia dërgojë njëkohësisht prokurorit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.*

*4. Gjykata thërret kryesisht Kryeadministratorin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për të marrë informacion për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe për çdo të dhënë tjetër që e konsideron të dobishme për vendimin e konfiskimit. Kryeadministratori i Agjencisë mund të delegojë një nëpunës në varësi të tij për t'u paraqitur përpara gjykatës.”*

Për gjithçka sa më sipër, Gjykata përfundimisht çmon se pasuria e përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi duhet sekuestruar përkohësisht, për një periudhë gjashtëmuore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj, për shkak se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie se



pasuria rrjedh nga veprimitaria kriminale e kryer nga zotëruesi i saj, personi Fation Dautaj.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata, bazuar në nenet 3, 4, 5, 7, 11, 12, 15, 18, 20 të Ligjit Nr. 10192, datë 3/12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimtit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;

**VENDOSI:**

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
- Sekuestrimin e përkohshëm të pasurive si më poshtë vijon:
  - a) Njësi me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 44, Faqe Nr. 239;
  - b) Truall me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup>, plus ndërtesë me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Nr. 8150, Volume Nr. 20, Faqe Nr. 61;
  - c) Automjet “Mercedes – Benz”, tip ML 350 CDI, me targë AA434MN, në emër të Nezir Dautaj;
  - d) Automjet “BMW”, tip X5, me targë AA999IS, në emër të Fation Nezir Dautaj;
  - e) Automjet “BMW”, tip X5, me targë AA818LD, në emër të Fation Nezir Dautaj;
  - f) Automjet “Audi”, tip R8, me targë AA546KU, në emër të Isuf Nezir Dautaj;
  - g) Bar – Kafe “Piano – Bar”, në rrugën “Petronini Luarasi”, në afërsi të “Shkollës së Baletit”, Tiranë, në emër të Servete Dautaj, me NIPT: L62402043D.
- Caktimin e administratorit nga lista e ekspertëve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për ekzekutimin e këtij vendimi, duke vënë në dispozicion të Gjykatës edhe listën e administratorëve me personat e punësuar dhe të autorizuar prej saj.
- Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, për ekzekutimin e këtij vendimi.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, Brenda 15 ditëve, i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Kukës me 10/3/2020!

Sekretare  
Lazime Sefer



Gjyqtar  
Florin Demollari  
  
Florin Demollari  
9



Ky vendim është ankuar në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila me vendimin e saj nr 75 datë 16.04.2020 ka vendosur;

- Lënien në fuqi të vendimit nr 220 (396) datë 10.03.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës
- Kundër vendimit lejohet recurs në Gjykatën e Lartë Brenda afatit ligjor që është 45 ditë nga shpallja e vendimit.

KANCELARI  
E AUTORIZUAR SEKRETARE

